

Språkporten – Välkomst Burlöv

(Alb.)

Shkollë e përkohshme për fëmijë të sapoardhur

Fillimi i shkollës për nxënësit e sapoardhur në Burlöv 6-18 vjeç

Nëse keni një fëmijë që do të fillojë parrashkollorin ose shkollën për herë të parë në Suedi, mund të kontaktoni Medborgarservice (shërbimin për qytetarët) në numrin e telefonit: 040-625 60 00 apo të kontaktoni direkt Välkomsten (shkollën për të sapoardhur në Suedi në numrin e telefonit 040-625 62 63.

Välkomsten (shkolla për të sapoardhur në Suedi) ndodhet në adresën: Kärleksgatan/Lundavägen 26 i Arlöv, në të njëjtën ndërtesë me Vårboskolan.

Para se fëmija të fillojë shkollën, prindi duhet të regjistroj apo raportoj fëmijën në recepsion të shkollës (Välkomsten/Vårboskolan) dhe ti plotësojë dokumentat e regjistrimit. Këto dokumenta duhet ti plotësojë dhe ti nënshkruajë prindi apo kujdestari i fëmijës. Po ashtu prindi duhet të ketë me vete kërkesën/dëshminë e azilit kërkit /LMA-kort kartelen e identifikimit në shtetin e Suedisë, e po ashtu edhe notat e fëmijës nga shkolla paraprake, nëqoftëse i posedoni.

Biseda rreth shëndetit

Para se fëmija të fillojë shkollën do të ketë një bisedë rreth shëndetit të tij së bashku me infermierën e shkollës.



Më shumë informacion në anën e pasme



Hartimi/planifikimi për vazhdimin e shkollimit

Pastaj bëhet një hartim/planifikim në lidhje me gjuhën e fëmijës dhe përvojën e tij të mëparshme shkollore, aftësitë në shkrim dhe numërim të cilat më pas shërbejnë si bazë për vazhdimin e shkollimit të nxënësit. Hartimi/planifikimi bëhet në gjuhën amtare të fëmijës nga një mësues adekuat i po të njëjtës gjuhë. Të gjitha informacionet përmbledhen në një profil (dosje) në mënyrë që drejtori i shkollës të mund të përbushë sa më mirë nevojat e nxënësit për mësim të mëtutjeshëm.

Një shkollë e re pas Välkomsten (shkollës introductive për të sapoardhur)

Nxënësit e sapoardhur në Burlöv shkojnë në shkollën Välkomsten (shkollë për të sapoardhur) maksimumi rreth dy muaj. Pas kësaj, nxënësi fillon shkollimin në një shkollë tjetër në komunën Burlöv.

Mësimdhënia në shkollën për të sapoardhur/ Välkomst Burlöv

Në Välkomst (shkollën për të sapoardhur) nxënësit mësojnë suedisht, matematikë dhe njohuri mbi shoqërinë suedeze.

Shërbimi social

Shërbimi social punon për të siguruar jetesën e fëmijës në kushte të sigurta dhe të mbrojtura. Shërbimi social ofron mbështetje dhe ndihmë për fëmijët dhe prindërit të cilët janë viktimë të dhunës ose abuzimeve të ndryshme.

Språkporten – Välkomst Burlöv

(Alb.)

Shkollë e përkohshme për fëmijë të sapoardhur

Kujdesi shëndetësor dhe kujdesi dentar

Fëmijët dhe adoleshentët nën 18 vjeç të cilët kërkojnë azil kanë të drejtë për kujdes shëndetësorë dhe kujdes dentar njëjtë sikurse edhe fëmijët e tjerë të cilët jetojnë në Suedi. do të thotë i kanë të gjitha të drejtat e barabarta shëndetësore.

Të rriturit kanë të drejtë vetëm për kujdes shëndetësor dhe kujdes dentar në raste urgjente apo mjekime që nuk mund të presin.

Në Suedi, është e nevojshme të telefoni fillimisht dhe të tregoni se çfarë problemi apo shqetësimi shëndetësorë keni, për shembull të përshkruani simptomat e sëmundjes dhe pastaj do ju caktohet një kohë te mjeku nëse është e nevojshme.

Qendra shëndetësore Arlöv

040-623 41 00

Mbrëmjeve dhe gjatë fundjavës:

077-162 50 00

Adresa: Svenshögsvägen 6

Shërbimi dentar publik

040-623 01 00

Adresa: Hantverkargatan 24B

BVC-Qendrën e kujdesit për fëmijë

Në BVC-Qendrën e kujdesit për fëmijë, fëmija juaj merr kontrollë shëndetësore dhe vaksina që nga lindja e deri në moshën parashkollorit. Vizita në BVC (Qendrën e kujdesit shëndetësorë) është pa pagesë. Ju si prind merrni gjithashtu mbështetje dhe këshilla për shëndetin dhe zhvillimin e fëmijës suaj.

Në Suedi ekziston një program vaksinash për të siguruar që fëmijët të kenë mbrojtje të mirë dhe të sigurtë ndaj disa sëmundjeve të rrezikshme. Vaksinat janë gjithashtu falas dhe jepen në BVC (Qendrën e kujdesit shëndetësor)

Bisedë rreth shëndetit të të rriturve

Qendra shëndetësore Arlöv zhvillon biseda shëndetësore me të rriturit mbi 18 vjeç të cilët kërkojnë azil. Këto biseda zhvillohen nga një infermiere e specializuar. Gjatë bisedave ndër të tjera flitet edhe për shëndetin mendor, dhe po ashtu ofrohen teste për sëmundje të ndryshme.

I rrituri ftohet nga infermierja dhe nuk ka nevojë që të rezervojë vetë një takim për biseda shëndetësore për të rritur.



**Burlövs
kommun**

Bashkia Burlöv në bashkëpunim me Rajonin Skåne